

**SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së  
ŽALBENO VEĆE KAI**

**GSK-KPA-A-240/2015**

**Prishtinë**

16 Maj 2018

Në çështjen juridike të:

**“J.”, a. d.**

-e përfaqësuar sipas autorizimit nga Zh. F.

**Pala ankuese**

**Kundër,**

**H. Gj.**

**Pala përgjegjëse në ankesë**

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga Beshir Islami, kryetar i Kolegjit, Krassimir Mazgalov dhe Ragip Namani, gjyqtar, duke vendosur lidhur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/C/248/2014 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA27736), të datës 18 Qershor 2014, pas shqyrtimit gjyqësor të mbajtur më 16 Maj 2018, mori këtë:

## AKTGJYKIM

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e “J”,a. d., , kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/C/248/2014, të datës 18 qershor 2014, për sa i takon lëndës së regjistruar në AKP, me numrin KPA27736.
2. Vërtetohet Vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/C/248/2014, i datës 18 qershor 2014, për sa i takon kërkesës me numrin KPA27736.

### Përmbledhje e çështjeve faktike dhe procedurale

1. Më 19 shkurt 2007, “J”,a. d., e përfaqësuar nga Z.F. sipas autorizimit nr. 230 të 16 shkurt 2007 (më tutje: pala ankuese), ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës ( më tutje: AKP) me të cilën kërkon ri-posedimin e lokalit afarist. Ai pretendon se Agjencia “J”, të cilën e përfaqëson, është pronare e lokalit afarist në sipërfaqe prej 53,64m<sup>2</sup>, i cili gjendet në adresën Lagja “Lakërishte”, Soliteri nr. 4, përdhes, numri i lokalit 16 në Prishtinë( më tej: prona e kërkuar). Pala Ankuese thekson se prona e kërkuar është uzurpuar dhe shfrytëzohet pa kurrfarë kompensimi duke iu nderuar edhe destinacioni.
2. Për të mbështetur kërkesën e saj, pala ankuese kishte dorëzuar në AKP provat vijuese:
  - Kontratë mbi bashkonim e mjeteve për ndërtimin e lokaleve afariste nr. 04-3183/1 e lidhur me datën 18 tetor 1978 në mes të Bashkësisë Vetëqeverisëse të Interesit për Banim dhe Lokale Afariste nga Prishtina, në një anë dhe Agjencisë,“J”.
  - Vërtetimin, nr. 03-2787/1 datuar 13 tetor 1992, të lëshuar nga Ndërmarrja Publike Banesore në Prishtinë sipas kërkesës së “J” -Beograd me të cilin vërtetohet se pala ankuese e ka blerë pronën e kërkuar në bazë të kontratës numër 03-3183/1,
  - Autorizimin nr. 230, të dt. 16 shkurt 2006, me të cilin Agjencia “J”,a. d., e autorizon palën ankuese që ta përfaqësoj në AKP lidhur me lirimimin e pronës së kërkuar,
  - Aktvendimin nr. BD.10692/2005 i datës 06 maj 2006, lëshuar nga Agjencia për Regjistra Ekonomik –(Regjistri i subjekteve ekonomike) në Beograd, me të cilin pala ankuese regjistrohet si Agjencia “J”,-shoqëri aksionare e hapur Beograd, në adresën e saj si më lartë, me Drejtor Ekzekutiv të emëruar Z. N.
3. Identifikimi i kërkesës ishte bërë më 26 Korrik 2007. Prona ishte e uzurpuar nga B. Gj. i cili ishte prezent gjatë identifikimit të pronës. Në AKP ishte paraqitur vëllai i tij H.Gj(më tutje: pala përgjegjëse në kërkesë) i cili e ka nënshkruar njoftimin e pjesëmarrjes në procedurë duke deklaruar se prona e kërkuar shfrytëzohet për qëllime banimi.
4. Pala përgjegjëse në kërkesë nuk kishte parashtruar asnjë dëshmi në mbështetje të përgjigjes së tij.

5. Dokumentet e parashtruara nga pala ankuese janë verifikuar pozitivisht për veç Vërtetimit nr.03-2787/1 me të cilin vërtetohet se pala ankuese kishte plotësuar obligimet ndaj ndërmarrjes publike banesore.
6. Më 18 qershor 2014, KKPK-ja me vendimin e saj KPCC/D/C/248/2014, e kishte hedhur poshtë kërkesën e palës ankuese, me arsyetimin në paragrafin 32 se komisioni vëren se kërkesa e palës ankuese ka të bëjë me pronë të ndërmarrjes shoqërore e jo me pronë private. Pala ankuese ka paraqitur kërkesë në emër të ndërmarrjes shoqërore, dhe prona e kërkuar para ose gjatë konfliktit të vitit 1998-99 ka qenë në pronësi shoqërore. Në bazë të nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK, 2006/50, e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, juridiksioni i Komisionit është i kufizuar në kërkesa për pronë të pa luajtshme private.
7. Vendimi i ishte dorëzuar palës ankuese me datë 1 dhjetor 2014, ndërsa ankesë kishte paraqitur me datën 22 dhjetor 2014.

### **Pretendimet e palës ankuese**

8. Pala ankuese ka kundërshtuar vendimin e KKPK-së, duke theksuar se vendimi mbështetet në vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.
9. Sipas palës ankuese, mënyra e vendosjes së KKPK-së në vendimin e saj është e pa pranueshme dhe kontradiktore lidhur me kompetencën e këtij organi ashtu si theksohet në nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK, sepse pala ankuese nuk mund ta shfrytëzojë dhe posedoj pronën e kërkuar për shkak të rrethanave të konfliktit të armatosur. Po ashtu thekson se nuk është kontestuese që prona e kërkuar është pronë private pasi që ishte privatizuar në vitin 2003 dhe këtë fakt e thekson edhe komisioni si në vendimin e tij.
10. Pala ankuese në fund propozon që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovoj ankesën duke e anuluar vendimin e KPCK-së.
11. Pala ankuese bashkëngjit Aktvendimin mbi ndërrimin e titullit-emërtimin dhe Aktvendimin e Gjykatës Ekonomike në Beograd St.-4796/2012 të datës 18 dhjetor 2013 lidhur me hapjen e procedurës së falimentimit të ushtruesit të kërkesës.

### **Pranueshmëria e ankesës**

12. Ankesa është paraqitur brenda afatit prej 30 ditë, ashtu si parashihet në nenin 12.1, të Ligjit nr. 03/L-079, andaj është e pranueshme.

### **Arsyetimi ligjor**

13. Gjykata Supreme shqyrtoi vendimin e kundërshtuar në përputhje me dispozitat e nenit 194 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore nr. 03/L-006, (në tekstin e mëtejshëm: LPK), dhe pas vlerësimit të pretendimeve të palës ankuese, gjeti se ankesa është e pabazuar.
14. Gjykata Supreme konstaton se KKPK-ja ka marr vendim të drejtë dhe ligjor me hedhjen poshtë të kërkesës për shkak të juridiksionit, sipas arsyeve të dhëna si në arsyetim të vendimit. Kjo pasi që është vërtetuar se prona e kërkuar para dhe gjatë kohës së konfliktit të armatosur 1998-99 ka qenë pronë shoqërore.
15. Sipas nenit 3.1 të Ligjit 03/L-079, paraqitësi i kërkesës ka të drejtë për një urdhër nga KKPK-ja për ri-posedimin e pronës nëse paraqitësi i kërkesës “e dëshmon” të drejtën e tij pronësore apo të drejtën për shfrytëzimin e pronës private përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale dhe gjithashtu nëse e dëshmon se ai nuk është në gjendje të ushtroj të drejtën në fjalë për shkak të rrethanave që drejtpërdrejtë kanë të bëjnë me konfliktin e armatosur që ka ndodhur në Kosovë në mes të datave 27 shkurt 1998 dhe 20 Qershor 1999 apo për shkak të rrethanave që rezultojnë nga ky konflikt.
16. Nga dispozita e cituar në paragrafin paraprak pa dyshim rezulton se juridiksioni i KKPK-së është i kufizuar në kërkesa për prona të pa luajtshme private e jo për prona në pronësi të ndërmarrjeve shoqërore.
17. Gjykata Supreme e Kosovës i shqyrtoi pretendimet e palës ankuese se nuk është vërtetuar gjendja faktike nga organi i shkallës së parë si dhe theksimet e tjera të cekura si në paragrafin e nëntë të këtij aktgjykimi e në veçanti pretendimet kryesore se prona e kërkuar nuk mund të shfrytëzohet nga rrethanat e konfliktit të vitit 1998-99 dhe se kjo pronë është privatizuar në vitin 2003 dhe vlerëson se pretendimet e tilla nuk janë të qëndrueshme apo të bazuara në fakte dhe baza ligjore ndërsa vërteton se KKPK-ja ka vendosur në mënyrë të drejtë dhe meritore në vendimin e saj. Faktet e siguruara nga Sekretaria Ekzekutive e AKP-së dëshmojnë se ndërmarrja „J” „a. d., prona e së cilës kërkohet për tu kthyer në posedim dhe pronësi ka qenë ndërmarrje në pronësi shoqërore prej themelimit të saj në vitin 1947, gjatë viteve 1998-99 e deri në privatizimin e saj në vitin 2003 nga shteti i Serbisë.
18. Me qenë se privatizimi i kësaj prone si theksohet edhe nga pala ankuese është bërë në Serbi ky privatizim është jo relevant dhe nuk mund të ketë efekt juridik lidhur me pronën e kërkuar e cila gjendet në Kosovë sepse pronat shoqërore janë nën juridiksionin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit ashtu si parashihet në nenin 5 par.1.2 të Rregullores së UNMIK dhe Ligji nr.04/L-034. Andaj edhe në këtë drejtim pretendimet e palës ankuese refuzohen si jo të bazuara sepse pamundësia e ushtrimit të së drejtës së posedimit ndërlidhet edhe me faktin se me miratimin e Rregullores 2002/12 e ndryshuar me Rregulloren 2005/18, pronat shoqërore janë nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit.
19. Nga të lartë cekurat Gjykata Supreme konstaton se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë dhe mbi këtë bazë po ashtu rezulton se e drejta materiale dhe procedurale

është zbatuar në mënyrë të ligjshme , me mënyrën e vendosjes sipas kërkesës, si në vendimin e ankimuar, të KKPK-së.

20. Ky aktgjykim nuk e cenon të drejtën e palës ankuese, apo palës me interes juridik nëse e vlerëson të nevojshme, që të kërkoj të drejtën e pretenduar lidhur me pronën lëndore, në organin kompetent vendor, apo gjykatën kompetente.
21. Nga ajo që u tha më lartë, e në përputhje me nenin 13.3 nën-paragrafi (c), të Ligjit nr. 03/L-079, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### **Këshillë Ligjore**

Sipas nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

**Beshir Islami, kryetar i Kolegjit**

**Krassimir Mazgalov, gjyqtar i EULEX-it**

**Ragip Namani, gjyqtar**

**Timo Torkko, referente e EULEX-it**